



Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKVENDIMIN**  
**PËR**  
**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT, NË**  
**ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Bazuar në nenin 20, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Në referim të nenit 20, pika 2, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

Referuar nenit 22, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre.

Në nenin 179, pika 1, të Kodit Zgjedhor, parashikohet se sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje, do të implementohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 % të zgjedhësve, duke filluar nga zgjedhjet e para, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Komisioni Rregullator me vendimin nr.4 datë 13.11.2020 “ Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje, në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar karakteristikat teknike që duhet të kenë pajisjet elektronike që do të përdoren për votimin dhe numërimin elektronik.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Me vendimin nr.111 datë 2.3.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi zonën e administrimit zgjedhor nr.40, ku do të përdorej për herë të parë projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik.

Projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik u zbatua për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, në ZAZ nr. 40, Qarku Tiranë.

Në përfundim të këtij procesi, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, u realizua këqyrja paszgjedhore për 100% të pajisjeve të përdorura për votimin dhe numërimin elektronik duke u numëruar manualisht fletët e votimit të printuara nga pajisja, **e cila konfirmoi saktësinë 100% të rezultatit në pajisjet e përdorura për votimin dhe numërimin elektronik në zgjedhjet e datës 25.04.2021.**

Pas pilotimit të suksesshëm në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021 si dhe në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie, të datës 6 Mars 2022, në Bashkinë Vorë, ky projekt u zbatua dhe në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, në bashkitë: Elbasan, përkatësisht ZAZ 47, 48, 49, 50; Kamëz, përkatësisht ZAZ 27 dhe 28; dhe Vorë, përkatësisht ZAZ 26;.

Komisioni Rregullator me vendimin nr.16 datë 13.4.2023 “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ka vendosur që procesi i votimit dhe numërimit për bashkitë, Elbasan, Kamëz dhe Vorë të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).

Në përfundim të këtij procesi, me vendimin nr.800 datë 23.10.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e datës 14.5.2023” u realizua këqyrja paszgjedhore për 10% të pajisjeve të përdorura për votimin dhe numërimin elektronik duke u numëruar manualisht fletët e votimit të printuara nga pajisja, **e cila konfirmoi saktësinë 100% të rezultatit në pajisjet e përdorura për votimin dhe numërimin elektronik në zgjedhjet e datës 14.5.2023.**

Gjithashtu pas vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.539, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” dhe nr.536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” janë depozituar në KAS kërkesat ankimore nr.81 dhe nr.86, nga ‘Partia Lëvizja e Legalitetit’ dhe koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’ për bashkinë Kamzë si dhe kërkesa ankimore nr.85 datë 24.05.2023 e depozituar nga koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’ për bashkinë Elbasan.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave ankimore KAS ka vendosur për këqyrjen dhe numërimin e votave fizike në pajisjet elektronike të votimit dhe numërimin për QV nr.2373/01, QV nr.2481/01 dhe QV nr.2483 të bashkisë Elbasan si dhe QV nr.1575, QV nr.1597/02 të bashkisë Kamzë, pra numërimin në mënyrë manuale. Rezultati provoi përputhjen e plotë të numrit dhe vlerësimit të votave fizike me përmbledhësen e votimit elektronik, duke rrëzuar pretendimin e ankuesve, pra **duke ri konfirmuar edhe njëherë saktësinë 100% të procesit të votimit nëpërmjet pajisjeve elektronike (PEVN)** .

**Pra referuar të gjitha eksperiencave të deritanishme të votimit dhe numërimin elektronik nëpërmjet pajisjeve elektronike (PEVN) dhe numërimin manual të votave të gjendur në këto pajisje, është konfirmuar në të gjitha rastet saktësia 100% të procesit të votimit nëpërmjet pajisjeve elektronike (PEVN)** .

Duke pasur parasysh parashikimin e nenit 22 pika 4 të Kodit Zgjedhor : “...., votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme”, konsiderohen zgjedhjet e katërta të njëpasnjëshme, duke përfshirë edhe zgjedhjet e pjesshme të datës 6.3.2022,

si edhe parashikimet e nenit 23 pika 3 “Në rastet kur nga testimi parazgjedhor rezulton se sistemet apo pajisjet shfaqin defekte apo pasaktësi operationale, të cilat mund të cenojnë integritetin e tyre apo të procedurave, atëherë KQZ-ja mund të vendosë zbatimin e procedurave manualisht dhe të heqë sistemet apo pajisjet nga përdorimi në zgjedhjet e radhës”

apo parashikimin e nenit 20 pika 2 gërma c, mbi Kompetencat e Komisionit Rregullator : “... përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi”

Duke konsideruar : a) eksperiencat e deritanishme kanë provuar saktësinë 100 % të pajisjeve elektronike (PEVN) gjatë procesit të votimit dhe numërimin, b) zgjedhjet e datës 11.5.2025 konsiderohen zgjedhjet e katërta të njëpasnjëshme ku mund të përdoren këto pajisje, c) madhësinë e pritshme të përmasave të fletës së votimit për zonën zgjedhore, Qarku Tiranë (37 mandate).

Propozohet përdorimi i pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimin (PEVN) në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025 si më poshtë:

Aktualisht KQZ disponon 828 pajisje për votimin dhe numërimin elektronik (PEVN) dhe duke qënë se për çdo QV përdoren 2 pajisje PEVN si dhe sasinë rezervë të nevojshme, KQZ është në gjendje që të përdorë pajisjet e votimit dhe numërimin elektronik (PEVN) deri në 404 Qendra Votimi.

Duke pasur parasysh se Bashkia Tiranë ka 940 Qendra Votimi konstatohet se numri i pajisjeve në dispozicion është i pamjaftueshme për të zhvilluar procesin e votimit dhe numërimin elektronik në të gjitha Qendrat e Votimit të kësaj bashkie.

Varianti më optimal për përdorimin e pajisjeve të votimit dhe numërimit (PEVN) që disponojmë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025 është përdorimi i tyre në disa njësi administrative të bashkisë Tiranë dhe Vorë, të cilat ofrojnë avantazhe logjistike në menaxhimin si dhe votuesit janë të familjarizuar me këtë proces votimi.

Në zbatim të nenit 22, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me teknologjinë në zgjedhje, propozohet të implementohet ky projekt në Njësinë Administrative nr.1, Njësinë Administrative nr.3, Njësinë Administrative nr.5, Njësinë Administrative nr.8, Njësinë Administrative nr.9, Njësinë Administrative nr.10 të Bashkisë Tiranë si dhe në njësitë Administrative, Bërxull, Prezë dhe Vorë të Bashkisë Vorë në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.

**Daniela ALIMEMETI**

- Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

**Pavlina DOÇAJ**

- Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA**

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

Nr

prot

Data: .02.2025

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM  
PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT, NË  
ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “ë” dhe pika 2, shkronja “c”, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**VENDOSI:**

1. Në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025, procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në të gjitha Qendrat e Votimit të Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë dhe Vorë të përmendura në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Operatorët për funksionimin e pajisjes së Votimit elektronik (PEVN) do të emërohen nga Komisioneri dhe Nënkomisioneri.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**

Data: .1.2025 Nr: Ora:



“Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

**Lidhja 1**

Njësitë administrative të Bashkisë Tiranë dhe Vorë në të cilat procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN):

| <b>Bashkitë</b>  | <b>Njesia administrative</b> | <b>KZAZ-të</b> | <b>Numri i QV-ve</b> |
|------------------|------------------------------|----------------|----------------------|
| <b>Tiranë</b>    | Nr. 1                        | 32             | 56                   |
|                  | Nr. 3                        | 34             | 52                   |
|                  | Nr. 5                        | 36             | 94                   |
|                  | Nr. 8                        | 39             | 51                   |
|                  | Nr. 9                        | 40             | 70                   |
|                  | Nr.10                        | 41             | 31                   |
| <b>Vorë</b>      | Bërxull                      | 27             | 12                   |
|                  | Prezë                        |                | 7                    |
|                  | Vorë                         |                | 25                   |
| <b>Totali QV</b> |                              |                | <b>398</b>           |

*Shënim: Për çdo Qendër Votimi do të përdoren dy pajisje të votimit dhe numërimit elektronik*